



Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија
Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

11.01.2021

NJOFTIM

Lëshimi i udhëzimit laboratorik UL 1 – COVID 19 nga mjeku i zgjedhur

Në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 303/2020, u botua Vendim për ndryshim të Vendimit për përcaktimin e formularëve të parashikuar në Rregullore për Përmbajtjen dhe Mënyrën e Ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, me të cilin prezentohet formulari i ri i Udhëzimit laboratorik 1 - COVID-19- (SARS-CoV-2) - "UL1 – COVID - 19". Në Vendim u bë korrigjim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 311/2020, me të cilin është botuar edhe formulari i këtij udhëzimi, që është i nevojshëm të zbatohet në praktikë.

Me Udhëzimin laboratorik 1 - COVID-19- (SARS-CoV-2) - "UL1-COVID-19", i mundësohet mjekut të zgjedhur nga fusha e mjekësisë së përgjithshme, për arsye të monitorimit të gjendjes shëndetësore të personave të siguruar të sëmurë me COVID 19 të cilët janë në trajtim shtëpiak, të jetë në gjendje të lëshojë udhëzim të tillë UL 1 – COVID - 19 për përcaktimin e vlerave të shërbimeve shëndetësore laboratorike biokimike: D-Dimer dhe CRP.

Udhëzimi mund të realizohet në:

- të gjitha institucionet shëndetësore publike (spitale dhe qendra shëndetësore),
- institucionet shëndetësore private që kanë marrëveshje me Fondin për shërbimet laboratorike UL 2
- institucionet shëndetësore private që kanë një marrëveshje me Fondin për të gjitha shërbimet e UL 1: UL 1-a, UL1-b, UL1-c dhe UL1-COVID 19 me mjek të punësuar specialist në biokiminë mjekësore që mund të kryejë këto teste laboratorike.

Në shtojcë janë të shënuara institucionet shëndetësore private që kanë lidhur marrëveshje me Fondin për të gjitha shërbimet laboratorike të përmendura më lart UL 1:

- ISHP POLIKLINIKA MEDICUS 92 - KAVADAR
- ISHP ALBIMINI - PRILEP
- ISHP LABORATORI BIOCIMIK DIAGNOSTIK MAKSIM - S - PRILEP
- ISHP LABORATORI BIOTEK - SHKUP
- ISHP LABORATORI AVICENA - SHKUP
- ISHP DIAMED – SHKUP

Shtojcë: Tabela e ISHP laboratorëve bartës të veprimtarisë, specialist mjekësor që mund të kryejë analizat e deklaruara laboratorike për personat e siguruar të sëmurë me COVID 19.

Me respekt,